ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
Ankesë

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**254-25-2958-1-2-1**
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **"Furnizim me material higjenik-Ritender**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

PM GROUP SH.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Anton Ceta Nr.3
(Adresa)

Prishtinë — **10000**
(Vendi) — *(Kodi postar)*

+38348881999 — N/A
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Pashtrik Mustafa
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpkpmgroup@gmail.com
(Adresa elektronike)

09.07.2025
(Data e parashtrimit të kërkesës) — (Nënshkrimi dhe vula)

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

Prishtinë
(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë dt. 11.04.2025 Data e hapjes së ofertave dt. 30.04.2025 Njoftimi mbi vendimin i dt. 25.06.2025 Kerkese per Qasje i dt: 25.06.2025 Lejimi per Qasje i dt: 16.06.2025 Kerkese per rishqyrtim : 27.06.2025 Refuzimi i Kerkeses Per Rishqyrtim : 02.07.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 56.3 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 108/A i LPP-së
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Njoftimi për kontratë në këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt. 11.04.2025 , ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt. 30.04.2025 ku kompania jonë kemi qenë ofertuese duke plotesuar te gjitha kriteret e Dosjes se Tenderit. Dhe jemi shpallur fitues nga Ak me daten 26.05.2025. Me dt. 26.05.2025 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me vendimin e AK-së, B42 – Letra standarde per tenderuesin e eleminuar per eleminim, ndërsa është rekomanduar për kontratë N.P.T BAJRA

Ne po ju bashkangjesim Refuzimin e kerkeses per rishqyrtim nga AK :

Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

ASHNA

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
Air Navigation Services Agency

02.07.2025

- Ne mbështetje te nenit 108/A pika 3 te Ligjit për Prokurimin Publik te Republikës të Kosovës Nr.04/L042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237- Ligji Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenit 4 të Rregullave për parashtrimin e ankesave te miratuar nga KRPP, sipas Kërkesave për Rishqyrtim nga operatori ekonomik PM GROUP SHPK me seli ne Prishtinë te datës: 27.06.2025, kundër Njoftimit Njoftimit mbi Vendimin e AK për procedurën e aktivitetit te prokurimit "Furnizim me material higjenik-Ritender" me nr. te prokurimit 254-25-2958-1-2-1, Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit pas analizimit, ekzaminimit dhe shtjellimit te kërkesave për rishqyrtim me datën: 02.07.2025 nxjerr:

VENDIM

I. **REFUZOHET SI E PABAZUAR** - Kërkesa për Rishqyrtim nga operatori ekonomik PM GROUP SHPK me seli ne Prishtinë te datës: 27.06.2025 për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material higjenik-Ritender" me nr. te prokurimit 254-25-2958-1-2-1, te publikuar nga Autoriteti Kontraktues Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

II. **VERTETOHET** – Njoftimi mbi vendimin e AK.

III. Vendimi hyn ne fuqi ne ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror - ASHNA, ka publikuar Njoftimi mbi vendimin e AK për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material higjenik-Ritender" dhe nr. te prokurimit 254-25-2958-1-2-1.

Operatori ekonomik PM GROUP SHPK me seli ne Prishtinë te datës: 27.06.2025, përmes platformës se prokurimit elektronik ka dorëzuar kërkesa për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi vendimin e AK si vijon:

Pretendimet ankimore

1. Mostra per pozicionin 20 – Leter tualeti treshtresore

Jemi njoftuar se arsyeja qe u shpallem te pasuksesshem ka qene se mostra per pozicionin 20 (leter tualeti treshtresore) kishte gjatesi 9.2 cm ne vend te 10 cm, sic kerkohej ne specifikat teknike.
Ky devijim minimal prej 0.8 mm eshte nje tolerancë teknike normale ne industrine e prodhimit te ketij produkti dhe nuk perben mospërputhje materiale, nuk ndikon ne cilesine dhe funksionalitetin e produktit.
Ne kemi dorëzuar edhe Deklaraten per permbushje te specifikimeve teknike, ku garantojmë se gjate ekzekutimit te kontrates produkti do jete plotesisht ne perputhje me kerkesat e Autoritetit Kontraktues.
Vendimi per te na perjashtuar per kete devijim te vogel eshte shkelje e drejteperdrejte e Ligjit per Prokurim Publik, konkretisht:
- Neni 7, paragrafet 1 dhe 2 – Parimet themelore te Prokurimit Publik, ku Autoriteti duhet te siguroje trajtim te barabarte, mosdiskriminim dhe proporcionalitet ne vleresimin e ofertave. Perjashtimi per nje ndryshim prej vetem 0.8 mm eshte joproporcional dhe diskriminues.
- Neni 59, paragrafi 4 – kerkese qe ne rast te ndonje devijimi te vogel ne moster, Autoriteti duhet te kerkoje sqarime nga operatori ekonomik dhe jo ta eliminoje menjehere pa shteruar mundesite ligjore.

Gjithashtu, Autoriteti Kontraktues ka detyrimin te shterroje te gjitha mundesite ligjore per te shpallur fitues ofertën me te lire, nese nuk ka mospërputhje materiale dhe kriteret jane plotesuar.
Ne kete rast, devijimi prej vetem 0.8 mm nuk ndikon ne cilesi apo funksion dhe nuk paraqet rrezik per kontraten.
Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.
Perjashtimi yne per kete arsye te vogel, ndersa oferta jone ka qene me e lire, shkel parimet e ekonomicitetit dhe menaxhimit te mire te fondeve publike, sipas Nenit 6 te Ligjit per Prokurim Publik.
Ne rastin konkret, fitues eshte shpallur NPT Bajra SHPK, me nje cmim me te larte per 3,278 euro krahasuar me ne (PM Group: 14,458 €; NPT Bajra: 17,736 €).
Oferta fituese gjithashtu permban gabime ne pershkrime teknike, si p.sh. vendosja e titullit te prodhuesit ne menyre te pasakte, qe tregon mungese serioziteti ne permbushjen e kritereve
Gjate qasjes qe na eshte ofruar nga Ak kemi verejtur qe ne mostrat e tije ka gabime psh:
Pozicioni: Detergjent për dysheme, standart për pllaka dhe keramika, njësia/paketimi 1 litër
Në ofertën e dorëzuar, tek përshkrimi i çmimeve, titulli i prodhuesit është shënuar si **ProKim SHPK**. Megjithatë, mostra e dorëzuar për këtë pozicion është produkt i prodhuesit tjetër, **Koral SHPK**, siç dëshmohet qartë edhe në fotografitë bashkangjitura.

Kjo mospërputhje midis ofertës së dorëzuar dhe mostrës së paraqitur tregon mungesë serioziteti dhe paqartësi në përmbushjen e kërkesave të tenderit. Kjo sjell në dyshim vlerësimin e saktë të ofertës dhe krijon pasiguri mbi përputhshmërinë reale të produktit me specifikimet teknike.

Në këtë mënyrë, rezulton se operatori ekonomik me këtë pozitë nuk garanton aftësinë për të përmbushur në mënyrë të plotë dhe të saktë obligimet e kontratës sipas specifikimeve teknike të kërkuara.

2 **Pozicioni 8: Shpuza me 2 anë (njëra e butë, tjetra e vrazhdë), dimensionet përafërsisht 18x7x2.5 cm**

Siq shihet Në ofertën e dorëzuar, tek përshkrimi i çmimit, titulli i prodhuesit është shënuar si **Cadi**. Pas një hulumtimi të detajuar në katalogun zyrtar të prodhuesit Cadi Cleaning , rezulton se ky prodhues nuk ofron shpuza me karakteristikat e kërkuara në specifikimet teknike, por vetëm produkte të tjera si fshisa dhe pajisje pastrimi të ndryshme. Siq mund te vertetohet tek
https://cadi-ks.com/

Kjo mospërputhje midis prodhuesit të deklaruar dhe produktit real tregon mungesë saktësie dhe besueshmërie në ofertë. Kjo ngre dyshime mbi aftësinë e operatorit për të përmbushur kërkesat e tenderit dhe për këtë arsye, ai duhet të konsiderohet i pa përgjegjshëm

3. **Pozicioni 35: Tela për enë kompleta (1x3)**

Operatori ekonomik i propozuar për kontratë nuk ka ofruar fare titull të prodhuesit, por vetëm ka përmendur "3 kom", çka dëshmon mungesë serioziteti dhe transparence në ofertë. Kjo tregon qartë që operatori është i pa përgjegjshëm dhe nuk ka përmbushur kërkesat minimale teknike të tenderit.

4. **Pozicionet 12, 13, 19, 28, dhe 29:**

- Thas mberturinash 60 litërshe me ngjyrë të zezë
- Thas mberturinash 120 litërshe me ngjyrë të zezë
- Brusha për WC
- Shporta për mbeturina 50 litërshe
- Kofe (set pastrimi: 5 copa të kuqe për toalete, 5 copa të kaltërta për kabinë, 5 copa të bardha për kuzhinë)

Në ofertën e dorëzuar, operatori ekonomik ka deklaruar titullin e prodhuesit si **Linda SHPK** për këto pozicione. Pas një hulumtimi të thjeshtë dhe verifikimi të kapaciteteve të kompanisë Linda SHPK, rezulton se ajo prodhon vetëm materiale për reklama dhe nuk ka te beje fare me prodhimin e qeseve për mbeturina, kofe apo brusha për toalet.

Kjo tregonmos-përputhje me kërkesat teknike të tenderit, duke ngjallur dyshime të arsyeshme për aftësinë e operatorit ekonomik për të përmbushur në mënyrë të plotë dhe profesionale obligimet kontraktuale.

Për këto arsye, kërkojmë që vendimi për shpalljen fitues të operatorit ekonomik të përmendur të anulohet, pasi ai është i pa përgjegjshëm dhe ka ofruar çmim më të lartë, duke dëmtuar interesat financiare të Autoritetit Kontraktues dhe të buxhetit publik.

Përgjigjia e AK

ASHNA ka shqyrtuar pretendimet ankimore te parashtuesit te kerkeses per rishqyrtim ku Zyrtari Përgjegjës i prokurimit, konstaton se është respektuar legjislacioni ne fuqi i LPP-së, RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK dhe Udhezuesi Nr-001_2023, ku oferta e përgjegjshme nga OE ka përmbushur kërkesat e specifikacionit teknik të dënë në DT si dhe ka dorëzuar mostrat në përputhje me këto kërkesa ndërsa oferta e dorëzuar nga nga OE PM GROUP SHPK ka dorëzuar mostrër per pozicionin 20 (letër tualeti treshtresore) me gjerësi prej 9.2 cm ne vend te 10 cm, sic kerkohej ne specifikat teknike dhe rrjedhimisht nuk ka përmbushur kërkesën e AK.

Këshille Juridike

Kundër çdo vendimit te marrë nga AK-ASHNA ne përputhje me rrethanat e nenit 108/24, çdo palë e interesuar mund të parashtroje ankesë pranë OSHP-së ne pajtim me nenin 109 te LPP-së.

Lulzim Rrecaj

ZYRTAR PERGJEGJES I PROKURIMIT

Vendimi i dërgohet:

- Operatorit Ekonomik PM GROUP SHPK
- Departamentit të Prokurimit

Date: 02.07.2025

Nga dëshmia e lartcekur shihet qartë se AK-ja nuk ka dhënë asnjë arsyetim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. E njëjta e ka cekur se nga konstatimet e lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi, mirëpo AK-ja nuk ka bërë asnjë konstatim të cilit mund ti referohemi.Në këtë rast e njëjta pasi që nuk ka mundur në asnjë mënyrë të dëshmoj të kundërtën epretendimeve tona ankimore, vetëm e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim pa ndonjë arsyetim,sepse nëse eventualisht pretendimet tona ankimore do të ishin të pa bazuara, atëherë AK-ja do ta dëshmonte me fakte konkrete një gjë të tillë mirëpo që nuk e ka bërë.

Duke u bazuar në të gjitha të lartcekurat dhe vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, kuptohet qartë se AK-ja nuk e ka respektuar nenin 108/A të LPP-së, paragrafi 9 ku specifikohet saktë si në vijim: *9. Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim.*
Përderisa pretendimet tona ankimore nuk janë analizuar fare nga AK-ja, ne kërkojmë nga ana e panelit shqyrtues të OSHP-së dhe ekspertit shqyrtues, që ti analizojnë në detaje pretendimet tona ankimore, sepse në këtë rast po diskriminohemi ne si OE të interesuar në këtë aktivitet, ndërsa po favorizohen OE të caktuar..

Duhet theksuar se në industrinë e prodhimit të letrës higjienike, toleranca standarde e deklaruar në çdo paketim është **±-5%**, çka e bën këtë devijim objektivisht të pranueshëm dhe brenda kufijve teknikë të zakonshëm. Përjashtimi i ofertës sonë për këtë arsye është joproporcional dhe tregon mungesë të një vlerësimi real dhe të drejtë të rrethanave të faktit dhe të standardeve të industrisë.

Ky vendim i Autoritetit Kontraktues është **diskriminues**, duke shkelur **Nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik**, i cili garanton trajtim të barabartë, mosdiskriminim dhe proporcionalitet në vlerësimin e ofertave.

Për më tepër, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me **Nenin 59, paragrafi 4 të Ligjit për Prokurimin Publik**, i cili obligon që, në rast të devijimeve të vogla ose gabimeve jo materiale, të kërkohet sqarim nga operatori ekonomik dhe jo të merren masa përjashtuese pa shteruar mundësitë ligjore të korrigjimit. Në këtë rast, AK ka përjashtuar ofertën tonë pa mundësuar sqarim, duke zbatuar një qasje tepër formale dhe të ngurtë.

Si pasojë e këtij vendimi të pabazuar, Autoriteti Kontraktues ka shpallur fituese një ofertë me vlerë **17,736 €**, duke refuzuar ofertën tonë më të ulët prej **14,458 €**, dhe duke shkaktuar kështu një dëm të panevojshëm për buxhetin publik në shumën **3,278 €**, për një arsye minimale dhe të pajustifikueshme.

Ndersa tek pretendimi jone ankimor 2

Këtu vërehet qartë se Autoriteti Kontraktues nuk ka kthyer asnjë përgjigje lidhur me pretendimet tona të detajuara dhe të argumentuara në kërkesën për rishqyrtim, të cilat përfshijnë:

1. Mospërputhjen midis mostrës së dorëzuar dhe prodhuesit të deklaruar për pozicionin 20 (letër tualeti), ku mostra është nga prodhues tjetër (Koral SHPK), siç dëshmohet me fotografitë bashkëngjitura, gjë që krijon dyshime serioze mbi përmbushjen e kërkesave teknike.
2. Mospërputhjen e prodhuesit të deklaruar në pozicionin 8 (shpuza me dy anë), ku prodhuesi i shënuar (Cadi Cleaning) nuk ofron produktin e kërkuar sipas katalogut zyrtar.
3. Mungesën e specifikimit të prodhuesit për pozicionin 35 (tela për enë kompleta), duke treguar mungesë serioziteti dhe transparence në ofertë.
4. Mos-përputhjen e kapaciteteve të prodhuesit të deklaruar (Linda SHPK) për pozicionet 12, 13, 19, 28 dhe 29 (thasë, brusha, shporta, kofe), pasi kjo kompani nuk është prodhues i këtyre produkteve, duke ngritur dyshime për aftësinë e operatorit ekonomik për të përmbushur kërkesat kontraktuale.

   Është për t'u habitur që Autoriteti Kontraktues shpall fitues një operator me gabime të dukshme në ofertë dhe me tendencë për të mashtruar AK, duke paraqitur prodhues tjetër në mostrë e një tjetër në përshkrim, ndërsa ne eliminohemi për vetëm 0.8 cm devijim

Sipas **Neni 108 të Ligjit për Prokurimin Publik**, Autoriteti Kontraktues ka detyrimin ligjor që të trajtojë dhe përgjigjet në mënyrë të plotë dhe të arsyetuar çdo pretendim të parashtruar

nga operatorët ekonomikë në kërkesat për rishqyrtim.

Në rastin konkret, mosdhënia e përgjigjes për pretendimet e mësipërme përbën shkelje të qartë ligjore, e cila cenon të drejtën tonë për një shqyrtim të drejtë dhe të plotë të ofertës sonë dhe krijon pasiguri dhe mungesë transparence në procesin e prokurimit.

Për këto arsye, kërkojmë nga OSHP që të konstatojë këtë shkelje ligjore nga ana e Autoritetit Kontraktues dhe të anulojë vendimin për shpalljen fituese të operatorit ekonomik të përmendur, duke urdhëruar rivlerësimin e plotë të ofertave në përputhje me ligjin dhe parimet e prokurimit publik.

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE **PM GROUP SH.P.K**
ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve na janë shkaktuar dëme në vlerë rreth 3 mijë euro deri më tani.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*